D E K R E T
Nr.1349, datë 10.1.1996

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7681, DATË 4.3.1993, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7994, DATË 14.9.1995 "PËR ADMINISTRIMIN E TATIMEVE E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në nenin 10, pas pikës "c" shtohen pikat "ç" dhe "d" me këtë përmbajtje:

"ç. Të kontrollojnë ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve fizike e juridike për pajisjen e tyre me certifikatë tatimore.

d. Të kontrollojnë dokumentimin e ruajtjes, të përdorimit dhe lëvizjes së mallrave e materialeve, si dhe lëvizjes së udhëtarëve në të gjitha llojet e transportit të brendshëm".

Neni 2

Pas nenit 16 shtohet neni 16/1 me këtë përmbajtje:

"Konsiderohen shkelje:

a) ushtrimi i veprimtarisë nga ana e subjekteve fizike e juridike pa u pajisur me certifikatë tatimore;

b) ruajtja, përdorimi dhe lëvizja e padokumentuar e mallrave e materialeve, si dhe lëvizja e udhëtarëve në të gjitha llojet e transportit të brendshëm.

Shkeljet e parashikuara në këtë nen, pavarësisht nga ndjekja penale, dënohen edhe me këto masa administrative:

Për shkeljet e pikës "a" me gjobë 500 000 lekë, bllokimin e menjëhershëm të veprimtarisë, sekuestrimin e mallrave, objekt i kësaj veprimtarie, si edhe sekuestrimin e të ardhurave të përfituara në mënyrë të paligjshme.

Për shkeljet e pikës "b" me gjobë 10 000 lekë dhe sekuestrimin e të ardhurave të përfituara në mënyrë të paligjshme dhe të mallrave, objekt i kësaj veprimtarie".

Neni 3

Në fund të paragrafit të parë të nenit 18 shprehja "nga zyrat e përmbarimit" zëvendësohet me shprehjen "nga organet e policisë tatimore".

Neni 4

Në fund të paragrafit të parë të nenit 28 shtohen fjalët "i Republikës së Shqipërisë", si dhe ndëshkohen me gjobë deri në një pagë mujore.

Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në rast konstatimi, nga ana e organeve të kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe degëve të saj në rrethe, të ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve pa u pajisur me certifikatë tatimore dhe moszbulimit të këtij aktiviteti nga punonjësit e policisë tatimore në përputhje me dispozitat e këtij dekreti, këta punonjës ndiqen penalisht sipas dispozitave ligjore në fuqi".

Neni 5

Ky dekret hyn në fuqi më 1.2.1996.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

Miratuar nga Kuvendi Populllor me ligjin nr.8064, datë 8.2.1996